



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 23/1 prot.

Elbasan, më 01. 1. 2026

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.117 datë 23.12.2025” Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis ASHK dhe Bashkisë Librazhd”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA



23

05.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.29.12.2025

Nr. 8574 prot

Nr.117 dt.23.12.2025

“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS ASHK DHE BASHKISË LIBRAZHD”

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisje Vendore”, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 26.06.2024 “Për një shtesë në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shtetërore”, Këshilli Bashkiak I mbledhur sot me date 23.12.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Të miratojë rinovimin e Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis ASHK dhe Bashkisë Librazhd.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe Pronës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU





BASHKIA LIBRAZHD

PROJEKT/VENDIM

Nr. ____ Prot

Datë __. __. 2025

Nr. __ datë __. __. 2025

“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS ASHK DHE BASHKISË LIBRAZHD”

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisje Vendore”, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 26.06.2024 “Për një shtesë në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shtetërore”, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës __/__/2025 të:

VENDOSI:

1. Të miratojë rinovimin e Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Librazhd.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe Pronës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI BASHKISË

MARIGLEN DISHA

P



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

RELACION

“Mbi miratimin rinovimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Librazhd dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”

Këshillit Bashkiak
Këtu

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisje Vendore”, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 26.06.2024 “Për një shtesë në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shtetërore”, dhe në bazë të vendimit të këshillit bashkiak nr. 92 datë 24.09.2024, është miratuar marrëveshja e bashkëpunimit midis Bashkisë Librazhd dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim koordinimin e veprimeve për përfundimin e procedurave të legalizimit të objekteve ndërtimore në zonat prioritare për zhvillim. Marrëveshja ka pasur një periudhë një vjecare zbatimi.

Gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes, është evidentuar se një pjesë e konsiderueshme e objekteve nuk ka përfunduar procesi i legalizimit. Kjo situatë ka krijuar nevojën për të siguruar vijimësinë e bashkëpunimit institucional. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresë nr. 13.178/1 datë 29.10.2025 ka kërkuar rinovimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për një afat deri më 28.12.2028, në mënyrë që të mundësohet finalizimi i procedurave të mbetura.

Duke marrë parasysh rëndësinë e vazhdimësisë së procesit të legalizimit, ju ftojme të miratoni rinovimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Librazhd dhe ASHK-së.

Konceptoi: Enxhi Xhyraj